

E pa besueshme por e vërtetë

nga Valentin Gocaj
(Ekspert i prodhimit bujqësor)

Sapo kalon Uren e Bunes ne drejtim te zones Ana Malit, menjehere syri te pushon ne masivet e medha me afro 90000 rrenje ullinj te te gjitha varieteve te cilet shtrihen ne kodrat e kesaj zone.

Ne çdo familje majtas e djathtas rruges do te shohish te shpalosur te gjithë traditen Anamalese te kultivimit te perimeve si ne fushe ashtu edhe ne serra e tunele. Tradite kjo e trasheguar brez pas brezi deri ne dite e sotme, deri ne krijimin e llojeve autoktone tashme te njohur ne te gjithë Shqiperine.

Por krahas kultivimit te perime shikon te harmonizuar shume mire shumllojshmerinë e pentarise, duke filluar nga ato tradicionalet deri tek agrumikultura. Aty do te gjesh që nga shega që është me shumice, fiku i famshem i Krebajve (“Tivaras”) e deri tek pemet e rralla si kimça e te tjera.

Te gjitha keto jane nje kombinim i shkelqyer i kushteve ekologjike, agropedologjike te kesaj zone te mbrojtur nga Veriu nga mali i Taraboshit, te ngrohur nga deti, te freskuar e ujitur nga lumi Buna, me Anamalasin, siç e cilesonte Pader Anton Harapi “ **Njerez te urte e shum puntor**”.

Te gjitha keto i quan krejte gjera normale per nje zone me tradita bujqësore si Ana e Malit. Por habia dhe e pa besueshmja doli nje dite kur me nje grup pune bënim studimin e pyjeve komunale te zones Ana Malit.

Ne fshatin Shtuf te kësaj komune ,ne lagjen Velaj , ne nje lugin te vogel mes dy kodrave te mbuluar me pyje dushku , dallojme nje peme te stermadhe afro 100 vjeçare me diameter 60 cm. Kjo eshte nje **dardhe** e cila vazhdonte te japë prodhim. Shoqëruesi jone një vendas nga Shtufi na tregon se kjo dardhë ishte e **shartuar mbi Lis**.



Pema e dardhes



Pika e shartimit



trung lisi

Pasionanti **Sait Velaj** (i cili tashme nuk jeton), e perjetsoi pasionin e tij duke bërë te pazakonshmen, duke **shartuar dardhën mbi lisi**, (dhe kjo duket qarte po ta shikosh). Jane te njohur shume lloje shartimesh por kjo midis dy gjinive krejt te largeta dhe te ndryeshme është diçka pothuajse e pa besueshme. **Dardha** bën pjesë ne familjen e Trendafiloreve (Rozaceae dhe ne gjinin Pyrus me rreth 30 specie) ndersa **Lisi** ben pjesë ne familjen Fogaceae, ne gjinin "querqus" me mbi 150 specie). Por kjo dardhe shekullore është një deshmi e gjalle e ketij realiteti.

Perputhja është e habitëshme sepse si nën shartesa (lisi) dhe mbishartesa (*dardhë vendi Verdhukla*) kane te njejtin zhvillim, te njejtën trashësi por që dallohet qartë pika e shartimit. Kembengulja e tij, duke bere shum e shum lloje shartimi, arriti te bente ate te pabesueshmen që vetem kur e shikon me syte e tu je detyruar te bindesh per kete mrekulli popullore.

(Zamir Velaj) (Osman Velaj)





%

Shënim: Materiali u ofrua nga Prof. As. Dr. Ilir Çiçi, ish anëtar i stafit akademik të Institutit të Resurseve Gjenetike të Bimëve (në pension): <http://qrgj.org/2015/11/stafi/>